

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**


**Për Programin e studimit BSc Teknik Laboratori Mjekësor**

**Universiteti ALDENT**

**Eksperti i vlerësimit të jashtëm:**

**Dr. Shk. Nevila HETA**

**Prof. As. Vjollca DURRO**




(Gusht /2019)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit BSc Teknikë Laboratori Mjekësor

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Aldent"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMAS Nr. 187, datë 22.04.2016
4	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor
5	Cikli i studimit:	Cikli i parë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/6 semestra
7	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
15	Aktivizimi i programit të studimit	2016 - 2017
16	Nr i studenteve	
	2016-2017	57
	2017-2018	46
	2018-2019	69



## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Teknik Laboratori Mjekësorë

Universiteti Aldent është institucion jo publik i arsimit të lartë i krijuar në vitin 2006 i liçensuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.673, dt.27.09.2006” Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, “Aldent” dhe në vitin 2013 ka fituar Statusin Universitet me VKM Nr.539, datë 13.06.2013 “Për miratimin e ndryshimit të statusit të shkollës së lartë universitare”. Aktivitetin si institucion arsimorë Universiteti “Aldent” e ka filluar në vitin 2003 si shkollë profesionale në programin e studimit “Laborant Dentar” - cikël 2 vjeçar. Në mars të vitit 2016 u riakreditua insitucionalisht nga APAAL me ekspertë ndërkombëtare, për një periudhë 6 vjeçare. Vlefshmëria e këtij akreditimi është deri në vitin 2022.

Bazuar në Urdhërin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 115, datë 13.03.2017 Universiteti “Aldent” përbëhet nga tre Fakultete që janë Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. UAL ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit si dhe kryhen kurse të edukimit në vazhdim për të gjitha specialitetet mjekësore.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga tre njësi bazë si Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri si dhe Qendra e Promovimit të Shëndetit. Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri ofron programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” me kohë të plotë në Teknike Laboratori Mjekësor i cili është objekt i këtij raporti.

Program i studimit “Teknike Laboratori Mjekësor” është hapur në bazë të urdhërit Nr.187, datë 22.04.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në Teknike laboratorit mjekësor në Universitetin ALDENT”. Ky program studimi në vitin e parë është ofruar nga Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi, ndërsa pas riorganizimit institucional bazuar në urdhërin Nr. 115, datë 13.03.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për riorganizimin e UAL” ofrohet nga Departamenti “Laborant Mjekësor dhe Imazheri”.

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Dr. Shk. Nevila Heta dhe Prof Asc Vjollca Durro ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Zj. Xhiliola Bixheku.

Në datë 08.07.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit me anë të sistemin MAS të ASCAL. Më datë 22.07.2019 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

**Komenti i GVJ** (fq 8 paragrafi fundit i raportit të GVJ) Gjatë vlerësimit të RVJ dhe dokumentacionit GVJ evidentoi që Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazher, ka 7 anëtarë efektivë prej të cilëve duhet 2 (dy) janë Profesor të asociuar

**Mendimi i GVJ:** Shprehemi dakord me sygjërimin e Universitetit Aldent sepse është lapsus në shkrim. Në RVJ po në këtë faqe një paragraph më lart jemi shprehur: Nga 7(shatë) PAE, 3(tre) kanë titullin Professor Asc.

**Komenti 2**(fq 9 paragrafi 3 i raportit të GVJ). Raporti PAE/PAK në programin e studimit për vitin akademik 2018-2019 është 13/12 52% me 48%. Raporti PAE/PA 13/25 dhe raporti PAE/student 68/13, afersisht 5 studentë mbulohe nga një pedagog. **Në RVB raporti PAE/student referohet 1/7.** **Mendimi i GVJ:** Pasi rishikua të dhënat e paraqitura në RVB dhe verifikimin të bëra mbi numrin e studentëve shprehemi dakord me sygjërimin e UA, pasi ne kemi vlerësuar raportin PAE/student dhe jo PA/student dhe i jemi referuar vetëm numrit të studentëve në vitit të parë të programit BSc në "Teknik Laboratori mjekësore" për vitin akademik 2018-2019. Pra raporti PA/student është 25/172.

**Komenti 3** (fq 9 paragrafi fundit i raportit të GVJ): Ngarkesa e stafit akademik është brënda normatimës të miratuar nga senati i UAL me vendim Nr 30, datë 03.09.2018. Ngarkesa maksimale që mbulojnë pedagogët në këtë program është 3 lëndë dhe 400 orë mësimorë, por u vu re se ka pedagogë që kanë zhvilluar katër (B.K), pesë(E.S.) apo 7 lëndë(A.S.) respektivisht 60 orë, 288 orë dhe 344 orë.

**Mendimi i GVJ:** Referuar tabelës "Lëndët dhe modulet të lidhura me personelin akademik për vitin 2018-2019" në fq 44 të RVB, GJV pas rishqurtimit të dokumentacionit si dhe sygjërimin nga UA konstatoi se me përjashtim të pedagogut BK që jep dy lëndë që janë Mikrobiologji përgjithshme dhe Mikrobiologji diagnostike(ku bëjnë pjesë dy module Virologji diagnostike dhe Mykologji dhe parazitologji diagnostike), për dy pedagogët e tjerë konstatimi qëndron sepse modulet që ato zhvillojnë janë pjesë të lëndëve të ndryshme.

**Komenti 4** (fq 10 i raportit të GVJ). Në konvertimin e krediteve ETC në orë mësimore janë përdorur raporte të ndryshme në lëndë të ndryshme psh në lëndët e vitit të parë dhe të dytë është përlogaritur 1 ETC me 10 leksione dhe 1 ETC 8 orë seminare. Në vitin e tretë ka lëndë që është përlogaritur 1 ETC me 11 orë leksione dhe lëndë 1 ETC me 12orë leksione, 1 ETC me 10 orë seminare dhe 1 ETC me 8 orë seminare.

**Mendimi i GJV:** Komenti 4 fq 10 qëndron sepse konstatimet në raportin e GJV bazohen në vendimin e senatit të UA dhe udhëzimit 15 të MASH. Sipas vendimit të senatit akademik nr. 311 datë 4.09.2017 konvertimi ETC në orë është: 1 ETC leksion është - 10 orë aktive në auditor dhe 15 orë jashtë auditorit, 1ETC seminare 8 orë aktive në auditor dhe 17 jashtë auditorit. Sipas udhëzimit 15 të MASH është: 1 ETC leksioni është 6-12 ore 1 ETC seminari është 6-8 ore auditor

**Komenti 5** (fq 25 paragrafi 2 i raportit të GVJ ). Në dy raste fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me sylabusin e lëndës në të cilën është lektor duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies.

**Mendimi i GVJ :** Komenti pestë qëndron sepse imunologjia dhe mikrobiologjia janë lëndë mjekësore që nuk mund të zhvillohen nga biologë megjithë eksperiencën disa vjecare të tyre në fushën e biologjisë.

**Komenti 6** (fq 22 pika 3 dhe 4 e konkluzioneve të raportit të GVJ ). GVJ i qëndron konkluzioneve të RVJ, Institucioni nuk ka zbatuar Kriterin 6 të Standarti VIII.1, në faqen e ëeb të Instucionit nuk ka pasqyrim të strategjisë dhe NJSBC-së dhe ndodhet vetëm një raport i vlerësimit të brendshëm që i takon vitit 2015-2016.

**Komenti 7** (fq 24, paragrafi 1 & 2, i raportit të GVJ) GVJ sqaron:

- a. Pjesa e parë e paragrafit në lidhje me përqindjen që zënë leksionet, nuk ishte e nevojshme të komentohet nga GVB pasi është vetëm një konstatim dhe koment pozitiv i GVJ.
- b. GVJ i qëndron komentit të RVJ në lidhje me mos pasqyrimin në kurrikul të orëve dedikuar projekteve në sylabuse, në një kohë që orërt janë cilësuar në programin mësimor dhe në RVB në kapitullin e Mesimdhënies.

**Komenti 8** (fq 24, paragrafi 2 i RVJ). GVJ jep sqarimin më poshtë në Komentin 11, pasi i referohet të njëjtit konkluzion.

**Komenti 9** (fq 27, konkluzioni 4 i raportit të GVJ). GVJ i qëndron vlerësimit të tij në RVB. Komentet që janë bërë në lidhje me ndryshimet në syllabus janë sugjerime të rëndësishme në lidhje me përmirësimin e cilësisë, kjo nuk ka lidhje me procesin e liçesimit të programit siç komenton Instucioni, pasi liçensim nuk do të thotë akreditim. Sigurisht këto ndryshime mund të bëhen në mënyrë graduale, kreative dhe të mirëstudiuar nga ana e institucionit, dhe sigurisht në bazë të ligjit dhe rregullores së brendshme.

**Komentin 10** (fq 26, paragrafi 4 i raportit të GVJ). GVJ i qëndron komentit të saj në RVB. Komenti është sugjerues dhe jo detyrues në funksion të përmirësimit të cilësisë, GVJ është i sigurt se ky sugjerim shkon gjithashtu në lehtësimin e punës së studentit duke i siguruar atij përvetësim me të mirë të dijeve. Përpilimi i broshurave apo leksioneve të shtypura nuk prek as lirinë akademike as të drejtën e autorit, siç komenton GVB.


**Komenti 11** (fq 28, paragrafi i fundit i raportit të GVJ). GVJ i qëndron konstatimit të RVJ, programi mësimor i depozituar ka mospërputhje me tabelat në RVJ. Ky është një gabim dhe pasaktësi e hartuesve të RVJ, të cilët kanë deklaruar për çdo vit akademik programe të cikleve të ndryshme. Në dokumentacion e hedhur në sistem pas vizitës në instucion, dokumenti Rialokimi i Krediteve është i pasaktë dhe GVJ nuk mund të japë gjykim. Plani mësimor i saktë është vendosur në sistem pas hartimit dhe shqyrtimit të draft raportit nga instucioni. ky koment është pasqyruar edhe në RVJ.

**Komenti 12** (fq 29, paragrafi 2 i raportit të GVJ). GVJ i qëndron konstatimit të RVJ, në dispozicion të GVJ nuk është vënë dokumentacion i cili përshkruan mënyrën e vlerësimit të studentëve. *Ky dokument është vendosur në sistem vetëm pas hartimit dhe shqyrtimit të draft raportit nga instucioni, ky koment është pasqyruar edhe në RVJ.*

**Komenti 13** (fq 29, paragrafi 3 i raportit të GVJ). GVJ i qëndron sugjerimit të saj në lidhje me mbrojtjen e diplomës nga një pjesë e studenteve në bazë të kriterëve të mirëpërcaktuara, mbrojtja e diplomës rrit cilësinë dhe motivon studentet.

**Komenti 14** (fq 34 paragrafi 3 i raportit të GVJ). GVJ i qëndron konstatimit pasi i është referuar mobilitetit të studentëve dhe stafit në këtë program studimi dhe jo në programe të tjera, ashtu sic vetë IAL e sqaron në këtë koment. Gjithashtu në RVJ është bërë koment i përkatës.

**Komenti 15** (fq 36 komenti i kriterit 4 të raportit të GVJ). GVJ i qëndron konstatimit, gjithashtu GVJ ka shtuar në raport sugjerim në lidhje me vlerësimin e praktikave profesionale.



## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit të ciklit parë Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësorë ka si mision përgatitjen profesionale teorike dhe praktike të studentëve lidhur me teknikat dhe metodat bazë të cilat aplikohen në laboratorët mjekësorë në fushën e mikrobiologjisë, biokimisë, hematologjisë, imunologjisë, histopatologjisë dhe gjenetikës mjekësore. Njohuritë e fituara në këtë program studimi i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e laboratorëve mjekësorë duke i bërë konkurentë në tregun e punës në sektorët shëndetësorë publikë dhe jo publik. Si dhe ju mundëson atyre ndjekjen e studimeve më të avancuara në ciklin e dytë të studimeve ( master profesional dhe master shkencor)

Objektivat e programit në përgjithësi janë të qarta profesionalisht, të justifikueshme dhe të arritshme. Program i studimit “Teknike Laboratori Mjekesor” është hapur në bazë të urdhërit Nr.187, datë 22.04.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor në Universitetin ALDENT”. Ky program studimi në vitin e parë është ofruar nga Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi, ndërsa pas riorganizimit institucional bazuar në urdhërin Nr. 115, datë 13.03.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për riorganizimin e UAL” ofrohet nga Departament “Laborant Mjekësor dhe Imazheri”.

Programet dhe planet mësimore në përgjithësi janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe kërkesat e sistemit të Bolonjës. Stafi akademik ka kualifikimin e nevojshëm për të realizuar programin mësimor në këtë cikël studimi. Ambientet për organizimin e procesit mësimor janë të përshtatëshme. Në funksion të programit janë laboratorë specifikë: mikrobiologjik, biokimik – klinik, histopatologjik, anatomisë dhe informatikës, të cilët janë të paisura me aparaturat të teknologjisë së avancuar duke i krijuar studentëve mundësi të njohin dhe praktikojnë teknikat dhe metodat e testimeve në laboratorë. Bashkëpunimi me institucionet shëndetësore publike dhe jo publike si spitale dhe qendra mjekësore diagnostike, krijon mundësi për aftësimin praktik të studentët. Biblioteka ka një numër titujsh në gjuhën shqipe dhe të huaj që i vijnë në ndihmë studentit për plotësimin e njohurive bazë të programit si dhe për zgjerimin e njohurive në fusha specifike gjatë punimit të temave të diplomës.

Pjesë e plotësimit të objektivave të programit “Bachelor” në Teknikë Laboratori Mjekësorë është hartimi dhe zbatimi i një strategjie afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit si rishikimi i vazhdueshëm i syllabuseve në përputhje me zhvillimin e kërkesave aktuale të diagnostikës laboratorike, përmirësimi i teknologjisë së laboratoreve eksistues, rritja e cilesisë së mësimdhënies, rritja e bashkëpunimit me instucione homologe të arsimit të lartë dhe shëndetësore.

Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” i referohet nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe organizohet në 180 kredite europiane (ECTS).

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p><b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>  <b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor” në përgjithësi, përmban elementët e domosdoshëm për aritjen emisionit dhe realizimin e objektivave në edukimin bazë teorik dhe praktik të studentëve specialistëve “Teknikë Laboratori Mjekësor”, familjarizimin e tyre me procedurat laboratorike dhe aftësimin profesionale të ty</p> <p>Programi i studimit ju siguron studentëve pasijen me njohuritë bazë në fushëm e mjekësisë laboratorike, aftësimin profesional teorik - praktik si dhe fitimin e kompetencës së duhur profesionale në përputhje me profilin e studimit duke ju mundësuar në përfundim të ciklit të studimit përshtatjen sa më të mirë në tregun e punës.</p> <p>Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shkencave mjekësore, teknologjisë dhe shërbimeve mjekësore të ofruara kanë sjellë një hop të madh zhvillimi dhe në fushën e diagnozës mjekësore laboratorike si dhe ritjen e kërkesës për staf laboratorit të kualifikuar. Aktualisht në Shqipëri nuk ka të dhëna të sakta për nevojat e tregut të punës për teknikë laboratorit. Fakte të rëndësishme që justifikojnë hapjen e këtij programi studimi janë numri i madh i laboratorëve mjekësorë si në sektorin publik dhe jo publik, zhvillimi i vrullshëm i shkencave mjekësore dhe në veçanti të mjekësisë laboratorike, përmirësimi dhe shtimi i metodave të reja testimi, shtimi i testeve të reja diagnostike, përmisimi i teknologjisë, informatizimi dhe automatizimi i procedurave laboratorike. Zhvillimi i mjekësisë laboratorike sjell si domosdoshmëri dhe formimin e profesionistëve të kualifikuar dhe cilësor në këtë fushë.</p> <p>Bazuar në këto të dhëna ky program studimi është i justifikuar dhe në përputhje me nevojat e tregut aktual të punës si dhe ritmet e zhvillimit social ekonomik të vendit, i cili kërkon burime njerëzore të kualifikuar në fushat respektive.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p>	<p>Programet e studimit të hartuara nga institucioni sipas legjislacionit në fuqi janë të ndara në lëndë formuese dhe karakterizuese si edhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion vlerësojmë si arritje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe rishikimin periodik të syllabuseve të lëndëve dhe planeve mësimore.</li> </ul>

**Kriteri 3** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

- Ngritjen e infrastrukturës së duhur për realizimin e programeve mësimore si sallat e leksioneve dhe seminareve të paisur me mjete e nevojshme didaktike. Në funksion të programeve të studimit për përgatitje të mirë praktike të studentëve janë ngritur laboratorët biokimik-klinik, mikrobiologjikë, histopatologjisë, anatomisë dhe informatikës.
- Lidhjen e kontratave të bashkëpunimit me institucione shëndetësore dhe arsimore publike dhe jo publike

Programet e studimit të ofruara mund të konsiderohen të përshtatura mirë me misionin dhe objektivat e zhvillimit të institucionit. Këto programe i ofrojnë studentit njohuri nga shkencat bazë mbi të cilat bazohen parimet e përgjithshme të Mjekësisë Laboratorike, njohuritë mjekësore për specialitete të veçanta si Gjenetikë, Biokimi Klinike, Hematologji, Sëmundje të brendshme, Imunologji, Histopatologji etj. Programi i studimit i siguron studentëve formimin e duhur profesional lidhur me organizimin dhe menaxhimin e laboratorit, procedurat laboratorike diagnostike si dhe fitimin e kompetencës dhe shprehive të duhura në zbatimin e njohurive në të gjitha nënspecialitetet e mjekësisë laboratorike.

## II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

### Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

**Kriteri 1** Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;
- c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Programi i studimit Bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësorë”, ka si qëllim plotësimin e kërkesat në rritje të tregut të punës për specialistë shëndetësorë në përgjithësi dhe teknikë të laboratorëve mjekësorë në veçanti. Zhvillimi social dhe ekonomik i vendit kërkon rritje në shtrirje dhe cilësi të shërbimit shëndetësor të popullsisë duke kërkuar shtimin e burimeve njerëzore sa më të kualifikuara. Mendojmë se ky program studimi është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik.

Këtë vit kalendrik 2019, mbaron brezi i parë i studentëve për “Teknikë Laboratori Mjekësorë” ku institucioni do të marrë dhe impaktin e punësimit të studentëve të tij në tregun e punës.

Studimi i tregut momentalisht është bazuar në evidentimin e pranisë së një numri të lartë të laboratorëve mjekësorë në Shqipëri, zhvillimit të vullshëm të teknologjisë, kërkesat e tregut të punës vendas dhe jashtë vendit, prioriteti që ka shërbimi shëndetësor në politikat qeveritare

Institucioni bazuar në kapacitet që ka në dispozicion si dhe numrin e studentëve në vitet e mëparshme parashikon të ketë një rritje të numrit të studentëve në vitin e ardhshëm akademik.

### Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p>	<p>Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, ofrimi i programeve në fushën e shëndetësisë lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien e vëndit, kjo është një vlerë për institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Promovimi i vlerave kombëtarë realizohet gjithashtu edhe ndërmjet aktiviteteve social-kulturore të organizuara.</p>
<p><b><u>Konkluzione të GVJ:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Programi i studimit bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hartuar në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e Institucionit.</li> <li>2. Institucioni për realizimin e misionit të tij është organizuar dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi duke ruajtur autonominë dhe lirinë akademike për aq sa e lejon ligji.</li> <li>3. Programi i studimit është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucionit dhe kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe kërkesat e sistemit të Bolonjës. Gjithashtu ai parashikon mundësinë për modifikime e përmirësime në përputhje me rezultatet e arritura dhe kërkesat e zhvillimit të profesionit dhe sistemit laboratorik në Shqipëri.</li> <li>4. Programi i studimit bachelor “Teknikë Laboratori Mjekësor” është i organizuar me kohë të plotë, me kohëzgjatje tre vite akademik me 180 kredite europiane, ku cdo vit akademik ka 60 ETC. Ne planin mësimor të vitit të tretë janë dhënë 8 lëndë me zgjedhje nga të cilat student zgjedh vetm 4.</li> <li>5. Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, ofrimi i programeve në fushën e shëndetësisë lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien e vëndit, kjo është një vlerë për instucionit.</li> </ol>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti “Aldent” bazuar në Urdhërin Nr.115, datë 13.03.2017 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë përbëhet nga tre fakultete që janë Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike i cili përbëhet nga tre njësi bazë si Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri dhe Qendra e Promovimit të Shëndetit. Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri ofron programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” me kohë të plotë në Teknikë Laboratori Mjekësor i cili është objekt i këtij raporti. Grupi i vlerësimit të jashtëm me anë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni u njoh me strukturën organizative, organiogramën e fakultetit, stafet në përbërje të njësive të tij.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Programi i studimit Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u verifikua struktura organizative e Universitetit bazuar në ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe statusin e Universitetit.

Struktura organizative e universitetit përbëhet nga pjesa akademike (organet drejtuese akademike, njësitë kryesore dhe njësitë bazë) dhe pjesa administrative (organet drejtuese dhe njësitë e shërbimit). Në krye të piramidës drejtuese akademike është Senati i Universitetit dhe Rektori; në varësi të tyre janë Dekanët e tre Fakulteteve, Njësia e sigurimit të brëndshëm të cilësisë dhe Dega mësimore. Gjithashtu institucioni ka në funksion edhe Këshillin Studentor.

Pjesa administrative përbëhet nga Bordi i Administrimit, organi më i lartë drejtues administrativ, në varësinë e të cilit është Administratori i Universitetit. Në varësi të Administratorit të Universitetit janë Administratorët e tre Njësive Kryesore.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga tre njësi bazë:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë,
- Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri
- Qendra e Promovimit të Shëndetit.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor është departamenti përgjegjës për programin Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësorë. Stafin akademik i departamentit përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë prej të cilëve 7 (shtatë) janë personel akademik efektiv dhe 11 (njëmbëdhjetë) personel akademik me kontratë (petagogë të ftuar).

Nga 7 (shtatë) PAE, 3 (tre) kanë titullin Professor Asc, 2 (dy) janë me Master Shkencor, 1 (një) është mjek specialist dhe 1 (një) në proces doktore. Nga 11 PAK 3 (tre) kanë titullin Profesor i Asociuar, 2 (dy) kanë gradën Doktorë Shkencash, 5 (pesë) janë me Master Shkencor dhe 1 (një) mjek specialist.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Pas vlerësimit të dosjes së bashku me dokumentat e aplikimit dhe vizitës së realizuar në institucion, GVJ arriti të kishte të dhënat e nevojshme lidhur me personelin akademik efektiv, personelin akademik me kontratë dhe personelin administrativ. Të dhënat e përshkuara në RVJ përfshinin (3 vite akademike, duke filluar nga viti akademik 2016-2017, 2017-2018 dhe vitin akademik 2018-2019). GVJ ju vu në dispozicion dokumentacion shtesë me tabela të përditësuara për vitin akademik 2018-2019.

Gjatë vlerësimit të RVJ dhe dokumentacionit GVJ evidentoi që Departamenti Teknikë Laboratori Mjekësor dhe imazher, ka 7 anëtarë efektivë prej të cilëve duhet 3 (tre) janë Profesor të Asociuar. Ndryshimet e bëra në stafin akademik kanë ndikuar në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Pas njohjes me dosjen e aplikimit dhe vizitës së kryer në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit "Aldent" grupi i vlerësimit të jashtëm pati në dispozicion informacionin e nevojshme lidhur me personelin akademik, personelin administrativ, shpërndarjen e ngarkesave mësimore mes personelit efektiv dhe personelit me kontratë për programin e "Bachelor" në Teknik Laboratori Mjekësor. Të dhënat në RVB i përkasin aktivitetit akademik të këtij programi për 3(tre) vitet akademike që funksionon ky program. Gjatë vizitës në institucion na u vunë në dispozicion dokumenta shtesë dhe gjithashtu të dhëna të përditësuara për vitin akademik 2018-2019.

Në programin Teknikë Laboratori për vitin akademik 2018-19, janë të angazhuar në mësimdhënie 25 personel akademik prej të cilëve 13 janë PAE { 2(dy) prej të cilëve kanë titullin Professor Asc, 2 (dy) kanë gradën Doktorë shkencash, 4(katër) janë me Master Shkencor, 2(dy) janë Mjek Specialist dhe 1(një) në proces doktorature} dhe 12 PAK {(prej të cilëve 2(dy) kanë titullin Profesor i Asociuar, 3(tre) kanë gradën Doktorë Shkencash, 3(tre) janë me Master Shkencor, 2(dy) mjek specialist, një në proces doktorature dhe 1(një) mjek përgjithshëm}.

Raporti PAE/PAK në programin e studimit për vitin akademik 2018-2019 është 13/12 52% me 48%. Raporti PAE/PA 13/25 dhe raporti PA/student 25/172, afërsisht 7 studentë mbulohen nga një pedagog.

**Numri i stafit akademik ka ndryshuar në mënyrë dinamike** gjatë viteve pas hapjes të këtij programi studimi si më poshtë:

Viti akademik 2016-2017 në këtë program studimi ka patur 6(gjashtë) PAE dhe 12(dymbëdhjetë) PAK; në viti akademik 2017-2018, 10(dhjetë) PAE dhe 14(katërmëdhjetë) PAK dhe vitin 2018-2019 janë 13 PAE dhe 12 PAK.

Ndryshime të rëndësishme ka ndodhur në dy vitet e fundit akademike(2017-2018 dhe 2018-2019) ku janë përfshirë në program 7(shtatë) pedagogë efektivë prej të cilëve 2(dy) janë me Titull Profesor i Asociuar dhe 2(dy) me gradën Doktorë Shkencash.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimit e Lartë dhe Kërkimin Shkencor Neni 59 pika 8 ku përcaktohet që institucionet Jopublike të Arsimit të Lartë përcaktojnë vetë ngarkesën mesimore. Gjatë vizitës në institucion na u vunë në dispozicion raporti i Departamentit Përgjegjës në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-2019 të miratuar me vendim të senatit akademik nr 30, datë 03.09.2018.

Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore konstatohet se në këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019, PAE mbulon 129.5 ETC ose 72% të ngarkesës mësimore, ndërsa PAK mbulon 50.5 ETC ose 28% të ngarkesës mësimore. Në RVB deklarohet se PAE në programin e studimit Bsc në "Teknikë laborator mjekësor" realizon 72% të krediteve të ngarkesës mësimore në auditor. Nuk vihet re mbingarkesë në orët mësimore të stafit akademik si efektiv ashtu dhe atij me kontratë. Ngarkesa e stafit akademik është brenda normativës të miratuar nga senati i UAL me vendim Nr 30, datë 03.09.2018. Ngarkesa maksimale që mbulojnë pedagogët në këtë program është 3 lëndë dhe 400 orë mësimore, por u vunë re se ka pedagogë që kanë zhvilluar pesë (E.S.) apo 7 lëndë (A.S.) respektivisht 288 orë dhe 344 orë.

Në konvertimin e krediteve ETC në orë mësimore janë përdorur raporte të ndryshme në lëndë të ndryshme

psh në lëndët e vitit të parë dhe të dytë është përlogaritur 1 ETC me 10 leksione dhe 1 ETC 8 orë seminare. Në vitin e tretë ka lëndë që është përlogaritur 1 ETC me 11 orë leksione dhe lëndë 1 ETC me 12 orë leksione, 1 ETC me 10 orë seminare dhe 1 ETC me 8 orë seminare.

Nga verifikimi i dokumentacionin GVJ konstatoi se në dy lëndë mësimi zhvillohet nga pedagogë specialiteti i të cilëve nuk përputhet me lëndën që ata japin. PAE me profesionin biolog (E. S.) jep lëndën imunologji, E. H. me profesion biologe jep mikrobiologji.

Bazuar në ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar titullari i lëndës duhet të jetë i Kategorisë Profesor. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni në të gjitha lëndët e zhvilluara në këtë program titullari i lëndës është me titullin Profesor ose Profesor i Asociuar. GVJ u njoh gjithashtu me mënyrat e rekrutimit të personelit dhe tipin e kontratës për të dy kategoritë e punonjësve akademike (PAE dhe PAK). Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UAI.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat Aneksi 1/2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Programi i studimit “Bachelor” në **Teknik Laboratori Mjekësor** është përfshirë në Departamentin “**Teknikë Laboratorë Mjekësor dhe imazheri**” në Fakultetin e Shkencave Teknike ku bëjnë pjesë 7 (shtatë) anëtarë personel akademik efektiv dhe 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë personel akademik me kontratë.

Ndërsa në programin Teknikë Laboratori mjekësorë janë të angazhuar në mësimdhënie 25 personel akademik prej të cilëve 13 janë PAE dhe 12 PAK si dhe personeli ndihmës akademik 1 (një) teknik laborator.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelën, Aneksi 3)

Stafi akademik efektivë i përfshirë në programin e studimit Teknikë Laboratori Mjekësorë me tituj dhe grada shkencore janë si vijon : 2(dy) kanë titullin akademik profesor i asociuar, 2(dy) me gradën Doktor i Shkencave, 4 janë me Master shkencor, 1(një) në proçes doktorature dhe 2 janë mjek specialist. Numri i stafit akademik ndihmës është 1(një) teknikë laborator.

Personeli akademik me kontratë në këtë program studimi që kanë tituj dhe grada janë si vijon: 2(dy) kanë titullin Profesor i Asc, 3(tre) janë Doktor shkencash, 3(tre) janë me Master Shkencor dhe 2(dy) janë mjek specialist, 1(një) është në proçes doktorature dhe 1(një) mjek përgjithshëm.

Personeli akademik që mbulon programin “Bachelor” **përbëhet kryesisht** nga pedagogë me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse.

- Të dhënat sipas seksit, Të dhëna sipas moshës së personelit

Në personelin akademik efektiv të departamentit “**Teknikë Laboratori Mjekësor dhe imazheri**” raporti meshkuj/femra është 2/5. Ndërsa në PAE të angazhuar në programin e studimit raporti meshkuj/femra është

**3/10.** Vihet rre një numër i lartë i femrave të përfshira në proceset akademike në përgjithësi, veçanërisht në degët e Mjekësisë Laboratorike.

**Në këtë program studimi** mosha e personelit akademik efektiv është e re, 7(shtatë) nga 11(njëmbëdhjetë) PAE janë të moshës nën 35 vjeç, ndërsa në personelin me kontratë, grup mosha që dominon është 36-45 vjeç. Në këtë grup moshe janë 5(pesë) nga 12(dymbëdhjetë) pedagogë me kontratë.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK, stafin ndihmës etj. Në diskutim me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik dhe ndihmës mësimit, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë. Rekrutimi i stafit në punë kryhet sipas legjislacionit të fuqi dhe akteve rregullore të miratuara nga UAL.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe ndihmës mësimit dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion me sondazhe u panë dokumentacione të tjera si dosje të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, dokumentacione të rekrutimit të pedagogëve të rinj, skema e procedurës së rekrutimit të pedagogëve, dokumente të shpërndarjes së ngarkesës mësimore të stafit akademik, programet mësimore, syllabuset, regjistri i matrikullimit të studentëve, procesvervale të provimeve etj.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Rekrutimi i stafit akademik bazohet në akte ligjore në fuqi. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Stafi akademik i punësuar me kohë të plotë për vitin akademik 2018-2019 mbulon 129.5 ETCS ose 72% të ngarkesës mësimore dhe stafi PAK mbulon 50.5 ECTS ose 28% të ngarkesës mësimore.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Procedurat ligjore për vlerësimin e personelit janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e FSHMT dhe të miratura nga senati akademik. Praktika e vlerësimit dhe formularët e performancës janë të miratura nga senati akademik. Procedura e vlerësimit është transparente dhe bazohet në disa tregues si: realizimin e ngarkesës mësimore të normuar, punën kërkimore-shkencore, kualifikimin, pjesëmarrjen në konferenca dhe referimin në to, planin e botimeve etj.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.	Institucioni disponon një bazë të dhënash mbi raportet e rekrutimit të personelit (dosje individuale), njoftimeve për vende të lira pune etj.
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit dhe kordinatorit për organizimin e programit të studimit, i cili është përgjegjësi i departamentit të teknik laboratorit mjekësorë dhe imazheri. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik. (dokumentacioni u verifikua).</p> <p>Institucioni (koordinatori i programit) disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, të personelit ndihmës mësimor-shkencor, ngarkesën e tyre mësimore si dhe listën e personelit administrative</p> <p>Institucioni përcakton dhe publikon në median e shkruar dhe elektronike, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët.</p> <p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni titullari i lëndëve që ka programi i studimit, ka titullin Profesor i Asc ose Profesor</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit ndihmës mësimor-shkencor me kohë të plotë, për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratoreve e mjediseve shkollore; kjo u konstatua qartë nga grupi i vlerësimit gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkencor.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ dëshmoi të ishte i angazhar në përmbushjen e objektivave të programit.</p> <p>Programi Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësorë përfshin praktika profesionale. Praktikant profesionale të studentëve kryhen në institucionet shëndetësore publike ose jo publike më të cilat universiteti Aldent ka kontratë bashkëpunimi. Praktika profesionale undhëhiqë dhe mbikqyret nga SAE ku është një tutor për 5-15 studentë.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni deklaroi se ka kryer aktivitete shkencore dhe leksioneve të hapura, pjesmarje të stafit akademik dhe student në aktivitetet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare apo vizita shkëmbim experience me institucione analoge në Turqi në funksion të kualifikimit profesional të personelit akademik.</p> <p>Të dhënat që lidhen me programin e studimit Bachelor në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë janë të pranishme pranë Departamentit përgjegjës.</p>

#### **Konkluzione të GVJ:**

1. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Procedurat e rekrutimit të personelit janë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e sanksionuara në statutin dhe rregulloren e institucionit.
2. Personeli akademik ndihmës dhe administrativ është i angazhuar dhe punon me përkushtim për përmbushjen e objektivave të programit të studimit “Bachelor” në Teknikë Laboratori Mjekësorë. Ai plotëson përgjithësisht detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucioni disponon një bazë të dhënash përfshirë dosjet individuale të tyre (CV, Informacioni mbi diplomat, kërkimin shkencor etj.) si dhe për shpërndarjen e ngarkesës mësimore vjetore.
3. Stafi akademik i punësuar me kohë të plotë për vitin akademik 2018-2019 mbulon 129.5 ETCS ose 72% të ngarkesës mësimore dhe stafi PAK mbulon 50.5 ECTS ose 28% të ngarkesës mësimore.
4. Mosha e personelit akademik efektiv, në këtë program studimi është relativisht e re.
5. Drejtimi i lëndëve e moduleve realizohet plotësisht nga titullarë të kategorisë profesor.
6. Institucioni ka organizuar programe specifike për kualifikimin profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor.

Gjatë vizitës në institucion na u referua se Universiteti Aldent është duke shtuar kapacitetet infrastrukturore me një kampus të ri Universitar me një sipërfaqe rreth 10.000 m<sup>2</sup>. Ambientet e Universitetit Aldent aktualisht përbëhen nga tre godina kryesore.

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë në dispozicion rreth 5000 m<sup>2</sup>, në të cilën përfshihen salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorë, zyra për stafin, bibliotekë, kafeteri si dhe një hapësirë të jashtëme të bollshme për ambiente të tjera dhe parking.

Në dokumentacionin shoqëruar të RVB (Aneksi 12) është paraqitur planimetria e ndarjes dhe organizimit të ambienteve mësimore dhe ndihmëse të UAL që u verifikuan.

Institucioni disponon sistem ngrohje--ftohjes qendrore, sistemi i sigurimit pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyjet hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve.

GVJ vizitoi auditorët mësimorë të cilat ishin të pajisura me video- projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ kishte ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.

Institucioni disponon një salle biblioteke të paisur me poste leximi dhe poste interneti të paisura me kompjuter, biblioteka kishte një numër konsiderueshëm titujsh librash profesional. Stafit akademik dhe studentet e UAL dispononin adresa të brendëshme emaili, në dispozicion të studentëve funksiononte portali i studentit i aksesueshëm përmes ëeb faqes [ual.edu.al](http://ual.edu.al). përmes të cilit studentët aksesonin të dhënat personale, rezultatet e provimeve si dhe informacione të tjera në funksion të procesit mësimor.

Në shërbim të procesit mësimor të studentëve të cilët ndjekin programin e studimit “Teknikë Laboratori Mjekësor” funksionin **tre laboratore mësimorë mjekësorë: Laboratori i Histologjisë dhe Anatomisë patologjike, Laboratori Biokimik, Laboratori Mikrobiologjik-Imunologjik**. Gjatë vizitës në këto laboratorë GVJ vuri re që ato ishin të paisur me të gjitha aparaturat dhe mjetet e tjera të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Hapësirat dhe pajisjet laboratorike ishin të përshtatëshme dhe të mjaftueshme. Gjithashtu në dispozicion të studentëve të këtij programi e studimi ishte Laboratori i Anatomisë dhe Laboratori i Informatikës.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**


Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione-14
- Klasa për seminare-8
- Salla për aktivitete promovuese-1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët-4 (GVJ verifikoi 3 laboratore të cilat i dedikohet direkt programit dhe Laboratorin e Anatomisë).
- Laboratorë informatike-1
- Salla interneti-1
- Salla për bibliotekë-1
- Zyrë informacioni për studentët-2
- Mjedise për aktivitete të qeverisë studentore-2
- Mjedise shplohëse-1
- Nyje hidrosanitare -30

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin-3
- Zyra për sekretarinë mësimore-2
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore-3
- Zyra për personelin akademik-6
- Zyra e zhvillimit të karrierës& Alumni -1
- Zyrë për Njësinë e SBC-1
- Salla për mbledhje-1

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion





Gjatë vizitës në institucion konstatuam se të dhënat e dosjes së vetëvlerësimit përputhen me gjendjen e konstatuar të ambienteve në dispozicion të programit të studimit si dhe në dispozicion të stafit. U vizituan dhe u verifikuan të gjitha ambientet në dispozicion të programit të studimit Bachelor.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj.</p> <p>Biblioteka e UAL pranë FSHMT dispononte një numër të mjaftueshëm titujsh dhe botimesh periodike në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Institucioni gjithashtu ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafin akademik bibliotekën online «Hinari» më qëllim realizimin me sukses të programit të studimit dhe të punës kërkimorë shkencore.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL u deklarua se UAL ka parashikuar pasurimin e bibliotekës me literaturë mjekësore bashkëkohore me rreth 20 mijë libra të rinj, në kampusin e ri universitar.</p> <p>Biblioteka kishte të afishuara oraret e shërbimit të cilat ishin në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me</p>	<p>Universiteti Aldent ka vënë në dispozicion të procesit mësimor një numër të mjaftueshëm laboratorësh, klasash, zyrash, auditorësh e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimeve.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me plotësimin e qëllimit të programit. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor dhe me të gjitha pajisjet e tjera të nevojshme.</p> <p>Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe të gjitha mjetet e tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit.</p> <p>Në funksion direkt të programin e studimit bachelor në "Teknikë Laboratori Mjekësor" janë tre laboratore mësimorë mjekësore: Laboratori i Histologjisë dhe Anatomisë patologjike, Laboratori Biokimik-</p>

programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

**Kriteri 6** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Hematologjik, Laboratori Mikrobiologjik-Imunologjik me kapacitet të mjaftueshëm për realizimin e oreve laboratorike dhe praktikës profesionale.

Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale UAL ka në zbatim marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe universitar dhe konkretisht për programin mësimor me rrjete të ndryshme laboratorësh.

#### **Konkluzione të GVJ:**

1. Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit paraqitet e përshtatshme dhe e mjaftueshme për realizimin e tij. Ambientet fizike sigurojnë infrastrukturë ndërtimore të mjaftueshme për realizimin e programit Bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.
2. Ambientet janë paisur me të gjithë paisjet e mjetet e duhura dedikuar zhvillimit të leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike.
3. Institucion disponon Laboratore mesimore Mjekësore në funksion direkt të zhvillimit normal të programit mësimor.
4. Ambientet administrative janë të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të stafit akademik e ndihmës dhe të studentëve.
5. Biblioteka është e paisur me literaturë universitare në gjuhën shqip e në gjuhë të huaj , në dispozicion të studenteve dhe stafit është dhe libraria elektronike.

#### **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti Aldent është një institucion privat i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Në RVB raportohet se burimi i vetëm i financimit janë tarifat e studentëve. Nuk ka të dhëna për tarifat konkrete në programit bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor”. Në RVB dhe gjatë takimeve të realizuar në IAL, na u deklarua se studentët përvec tarifës vjetore nuk paguajnë tarifa shtesë për ridhënie provimesh, praktika mësimore jashtë institucionit apo tarifa përshërbime administrative. Përdorimi i fondeve ka shkuar në drejtim të përsimit të infrastrukturës, investimit në laboratorë dhe auditore, shtimit të titujve në bibliotekë, proceseve të informatizimit, punësimit të stafit akademik të kualifikuar, financimit të veprimtarive shkencore.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):
- Grantet për kërkim- 0%
  - Konsulencat, shërbimet -0%
  - Tarifat për dhe gjatë shkollimit -100%
  - Sponsorizimet-0%
  - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)- 0%

- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj -0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, residencat, etj)- 0%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Pasqyra financiare e paraqitur ka të dhëna mbi koston për student për pesë vite akademike 2014-2018. Kostoja për student varion nga 176,956 ALL në 197,569 ALL. Të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të shprehur opinionin për raportin në përqindje. Në raport theksohet se tarifat për student janë të ulëta në raport me investimin në kushtet e mësimdhënies.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	Cdo vit Universiteti Aldent harton Projekt Buxhetin për vitin pasardhës ku merret parasysh edhe kostoja e hapjes së programeve të reja të studimit.
<b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	Po ashtu në përfundim të vitit kalendarik hartohen edhe pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e biznesit dhe masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar. Në përfundim të përpilimit të pasqyrave financiare bëhet auditimi i përvitshëm i tyre.
<b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare:	Institucioni ka hartuar raport financiar ku pasqyrohen në trajtë globale investimet, të ardhurat, shpenzimet, kostot e studentit etj. Institucioni ka dokumentuar raportet financiare për 5 (pësë) vitet e kaluara akademike.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;	Institucioni ka rritje në të ardhura me më shumë se dyfishim të tyre nga viti 2014 në vitin 2018 dhe nuk demonstron rritje signifikantë të kostos së studentëve. Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe mundësi investimi në drejtim të përmirësimit të kushteve të kushteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	
<b>Konkluzione të GVJ:</b>	
1. Universiteti Aldent është një institucion privat i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendëshme.	

2. Burimi i vetëm i financimit janë tarifatat e studentëve.
3. Institucioni dëshmon një rritje të qëndrueshmë financiare gjatë viteve të fundit duke treguar mundësi për investime të mëtejshme në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të kushteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në përmbushje të standarteve aktuale të cilësisë në arsimin e lartë, institucionalizimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë është detyrim ligjor për të gjithë institucionet e arsimit të lartë. Në këtë kuadër në Universitetin Aldent funksionon Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e cila ka si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tij dhe komponentëve përbërës të tyre si: programeve mësimore, stafit akademik, administrative dhe ndihmës. Institucion nuk ka vënë në dispozicion të GVJ vendim për ngritjen e NJSBC, GVJ evidenton praninë e kësaj strukture në Seksionin VII Neni 28 dhe 29 i Statutit të Institucionit dhe gjithashtu në Rregulloren e Universitetit e cila na u vu në dispozicion gjatë vizitës, pikërisht në nenet 14 dhe 15 në të cilat pëshkruhet organizimi, baza ligjore e ngritje së NJSBC-së, mënyra e funksionimit dhe kompetencat.

NJSBC funksionon në nivel institucional dhe në nivel fakultetesh. Grupi i vlerësimit të jashtëm kontaktoi me NJSBC. Njësia përbëhet nga 5 anëtarë nga të cilët një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga secili fakultet.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët -5
- Sa studentë janë anketuar-  
viti akademik 2016-2017 -35 studente,  
viti akademik 2017-2018- 54 studente  
viti akademik 2018-2019 semestri i parë - 40 studente
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

NJSBC ka përpunuar të gjithë pyetsorët duke nxjerrë dhe problematikat përkatëse sic ka qënë mungesa e sekretarisë elektronike në anketimin e vitit 2016-2017 dhe përsosja e laboratoreve në viti akademik 2018-2019.

- Cilat kanë qënë hapat e mëtejshëm

Hap i mëtejshëm pas nxjerrjes së rezultateve ka qenë prodhimi i raporteve përmblendhëse që i janë vënë në dispozicion stafit dhe studentëve.

Pas analizës së pyetësorit standart të ASCAL të cilët ishin zhvilluar në kuadër të akreditimit Institucional, NJBSC referon se ka bërë një rivlerësim të formularit të përdorur në të shkuarën për anketimin e studentëve. NJBSC ka aplikuar sistemin e anketimit semestral (në fund të semestrit, para provimit) të studentëve për vlerësimin e mësimdhënies, kurrikulës, organizimit të procesit mësimor etj. Në anketime janë përfshirë një numër i kënaqshëm studentësh. NJBSC ka përpunuar të dhënat e përftuara nga anketimet dhe kontrollet duke prodhuar dokumenta për përmirësimin e punës që konsistojnë në tabela krahasuese të vlerësimit për pedagogët, për paisjet, ambientet, performancën e programit etj. Problematikat e dala nga përpunimi i pyetësorëve janë adresuar dhe zgjidhur sic është vendosja e sekretarisë elektronike dhe investimi në laboratorët mësimorë i teknologjisë bashkëkohore në funksion të programit.

Në dokumentacionin shoqërues disponojmë Praktikën e vlerësimit të performancës akademike, formularin tip të vlerësimit, gjithashtu gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion Raporti i Rezultateve të pyetësorit të semestrit të parë për vitin Akademik 2018-2019. Grupi i vlerësimit u njoh me procesin e plotë në takimin me NJBSC.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë udhëhiqet nga NJBSC dhe përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit. (metodologjia e vlerësimit, dokument bashkangjitur aplikimit dhe i marrë në institucion)

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Tabelën 4, Aneks)

Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga 5(pesë) anëtarë, nga të cilët një ekspert i jashtëm dhe nga një përfaqësues për çdo fakultet të, ky grup udhëheq procesin e vlerësimit. Rezultatet e përftuara nga ky proces pas përpunimit dhe vlerësimit referohen në rrugë vertikale dhe horizontale (senat, departamente dhe fakultete)

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në dispozicion të GJV është vënë Raporti i NJSBC për vitin akademik 2017-2018 dhe Rezultatet e pyetësorit të semestrit të parë 2018-2019. Pyetësi i fundit është realizuar me anë të platformave të sondazheve online dhe organizimi i seksioneve të pyetjeve ka ndryshuar duke ndarë disiplinat dhe duke rritur peshën në vlerësim të mësimdhënies. Është paraqitur metodologjia e vlerësimit të brendshëm dhe modeli i pyetësorit me disa rezultate.

Disa nga rezultatet janë si më poshtë, vlera e demonstruar tregon përqindjen e studenteve të cilët kanë dhënë vlerësimin maksimal 5( shumë i kënaqur):

- Cili është vlerësimi juaj për Infrastrukturën e universitetit në tërësi? - 48.47%
- Si e vlerësoni cilësinë dhe performancën e personelit akademik? -51.34%
- Si e gjykoni punën e stafit drejtues dhe administrativ?- 50.67%
- A është përmbajtja e programeve tuaj të studimit në nivelin e duhur? -50.67%
- Cili është niveli i realizimit të laboratorëve dhe praktikave profesionale?- 50.86%

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Institucioni është i angazhuar në publikimin e vlerësimeve periodike në formën e raporteve vjetore. Institucioni monitoron në mënyrë periodike programet mësimore dhe procesin e mësimdhënies në funksion të sigurimit të cilësisë.

Problematikat e hasura nga pyetësorët i transmetohen nga NJSBC Rektorit i cili bën analizën përkatëse dhe më pas ja komunikon burimeve njerëzore ku plotësohet formulari vjetor mbi performancën e stafit. Vendimet mbi hapat që do të merren për përmirësim të problematikave diskutohen në senat dhe adresohen në mënyrë vertikale për zgjidhje.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë takimeve në institucion GVJ konstatoi se të dhënat e vetëvlerësimit përputhen me gjëndjen e konstatuar si dhe u njoh në detaje me mënyrën e funksionimit të NJSBC dhe strategjinë e saj. Gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion raporti i semestrit të parë të vitit akademik 2018-2019 , rregullorja e funksionimit të NJSBC-së dhe strategjia e zhvillimit institucional për periudhën 2016-2020.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	NJBSC e ngritur nga institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;	Institucioni e përdor këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë; informacioni përfshihet dhe në raportin e punës vjetore të institucionit.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	Publikimi i rezultateve të pyetësorëve është realizuar në formë raporti dhe i komunikohet stafit dhe studentëve.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:	Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta. Si metoda të tërthorta përdor sondazhet me anë të pyetësorëve dhe marrjen e informacionit të drejtpërdrejtë nga studentët me anë të sistemit tutorial.
Të tërthorta:	Në të njëjtën kohë Institucioni përdor dhe metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit si:
a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;	Fton studentët në diskutime të hapura duke
b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;	

<p>c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj.</p>	<p>mundësuar shprehjen e problematikave . Vlerësimi i studentëve përmes Testimeve, Seminareve, Detyra Kursi, Projekte, Prezantime në Povver Point, etj. Praktikat profesionale të kryera nga studenti mbikëqyren dhe vlerësohen nga pedagogu i caktuar nga departamenti si dhe nga drejtuesi i njësisë ku kryhet praktika (Qendra mjekësore). Programi bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor” ende nuk ka diplomuar student për të vlerësuar rezultatet e provimit të shtetit.</p>
<p><b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b> <b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Sigurimi i cilësisë është një ndër prioritetet e institucionit. Për të realizuar këtë objektiv institucioni përdor instrumentet e sugjeruar nga legjislacioni në fuqi dhe mbështetet në praktikat kombëtare për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Në statutin e institucionit janë parashikuar procedurat e menazhimit të cilësisë. Institucioni inkurajon takimet e herëpashershme formale dhe joformale të personelit me studentët me qëllim tërheqjen e opinionëve dhe informimin e studentëve në funksion të sigurimit të cilësisë. Strategjia për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë është pjesë e strategjisë të zhvillimit të institucionit. Strategjia e zhvillimit të institucionit na u vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që në ëeb nuk ka pasqyrim të strategjisë dhe të raporteve të NJSBC-së në ëeb.</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e riorganizuar në shkurt të vitit 2018 funksionon për të përmbushur detyrimet e saj.</li> <li>2. Institucioni përdor metodologji vlerësimi dhe instrumenta matëse për ecurinë e programit të studimit.</li> <li>3. Strategjia, politika dhe procedurat që ndiqen për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, iu prezantohen studentëve dhe në takime formale e joformale me personelin.</li> </ol>	

4. GVJ sugjeron që strategjia, procedurat dhe politikat në funksion të përmirësimit të cilësise të publikohën në ëeb ose në formë broshurash.

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Universiteti ALDENT, ka paraqitur në mënyrë të zgjeruar dhe të argumentuar misionin, objektivat e programit të studimit, përmbajtjen e programit të studimit, mënyrën e organizimit, planet mësimore, syllabuset , literaturën e rekomanduar etj.

Programi i ciklit të parë “Teknikë Laboratori Mjekësorë” ofrohet nga “Departamenti Laborant Mjekësorë dhe Imazheri” pjesë përbërëse e Universitetit Aldent. Misioni i këtij programi, përcaktur edhe në rregulloren e këtij programi, e cila na u në dispozicion gjatë vizitës në institucion, synon:

Përgatitjen me përgjegjësi të Teknikëve Laboratori Mjekësor të pajisur me standardet më të larta profesionale në kryerjen me cilësi dhe saktësi të shërbimit në laboratorët mjekësorë si dhe me aftësinë për t’u përshtatur në sistemin shëndetësor gjithnjë në ndryshim.

Të diplomuarit duhet të jenë të përgatitur me njohuri e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike me qëllim realizimin e një gamë të gjërë analizash në fushat e Laboratorëve Mjekësorë Klinik-Biokimik, Mikrobiologjik, Histopatologji dhe gjenetikë.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Program i studimit “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hapur më 22.04.2016 me urdhër Nr.187 të MAS “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor” në “Teknikë Laboratori Mjekësor”. Misioni i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Teknik Laboratori Mjekësor është përgatitja e studentëve me njohuri për teknikat bazë në fushat e Mjekësisë Laboratorike: Kimi Klinike, Hematologji, Mikrobiologji dhe Histopatologji.

Objektivi i këtij programi është që në fund të studimeve studentët e diplomuar të jenë të aftë të:

- Integrojnë të gjitha njohuritë e përvetësuara teorike dhe ti zbatojë në anën praktike.
- Analizojnë rezultatet laboratorike duke lidhur rezultatin me shkaqet e mundshme klinike.



- Kontrollonjë nga ana cilësore aparaturat dhe efikasitetin e testeve laboratorike të kryera me to.
- Zhvillojnë kreativitetin duke qenë inovativ në punën e tij dhe përdorimin me efikasitet të njohurive.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit ka qënë i organizuar në 3 vite akademike, 6 semestra me 90 javë mësimore në auditor dhe me 180 ECTS në total.

- Në 1 vit akademik: 30 javë mësimore në auditor
- Në 2 semestra: cdo semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Numri total i krediteve të programit është 180 ECTS
- 1 orë mësimore – 50 minuta
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë Bachelor, me emërtimin: **Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor.**

Planet mësimore, ku të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në planet mësimore dhe syllabuset është paraqitur numri total i ECTS-ve për cdo lëndë dhe ndarja e orëve mësimore sipas tipit të mësimdhënies. **Kategorizimi i lëndëve është bërë në bazë të VKM nr.41, datë 24.01.2018**), vihet re që shpërdarja e krediteve në bazë të llojit të veprimtarisë është bërë në mënyrë korrekte. Në planin mësimor përkatësisht 51.67% e ECTS-ve i përkasin disiplinave të formimit karakterizues (B), rreth 18.8% e ECTS-ve i përkasin disiplinave të formimit të përgjithshëm (A), rreth 13.61% e ECTS-ve i përkasin lëndëve ndërdisiplinore/integruese (C), rreth 11.94 % e ECTS-ve i përkasin lëndëve plotësuese (D), 3.89% e ECTS-ve i përkasin detyrimeve plotësuese.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet : 6-12 orë në auditor
- Për Seminaret : **nuk është evidentuar në RVB**
- Për Labororet : 18-25 orë në auditor dhe 0-7 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore : 20-25 orë në auditor dhe 0-5 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale : 20-25 orë në auditor dhe 0-5 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar: 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

Nuk ka një përcaktim të saktë për të diferencuar praktikën lëndore nga ajo profesionale, në programin e studimit pasqyrohen dy lëndë: Praktikë Laboratorike dhe Praktikë Profesionale.

GVJ vë re që ndarja e veprimtarisë brenda lëndës është e saktë, **vihet re që leksionet zënë jo me pak 50% e krediteve totale, ky raport nuk është praktikuar vetëm në praktikat laboratorike dhe profesionale.**

GVJ konstaton që në program ka lëndë të cilat kanë përfshirë si orë mësimore projekte, orë të cilat nuk janë përfshirë apo cilësuar në syllabyset përkatëse

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

(Tabelën në Aneksi)

Nuk ka ndryshime në planin mësimor krahasuar me planin mësimor të licensuar.

*GJV ve re që ka mos përputhje të krediteve të tabelës së veprimtarive formuese ne RVJ me planin mësimor. Plani mësimor i saktë është vendosur në sistem vetëm, pas hartimit dhe shqyrtimit të draft raportit nga instucioni. Squrimet e GVJ janë dhenë në memo.*

*Numri i stafit akademik ka ndryshuar në mënyrë dinamike gjatë viteve pas hapjes të këtij programi studimi si më poshtë:*

Viti akademik 2016-2017 në këtë program studimi ka patur 6(gjashtë) PAE dhe 12(dymbëdhjetë) PAK; në viti akademik 2017-2018, 10 (dhjetë) PAE dhe 14 (katërmëdhjetë) PAK dhe vitin 2018-2019 janë 13 PAE dhe 12 PAK.

Ndryshime të rëndësishme ka ndodhur në dy vitet e fundit akademike(2017-2018 dhe 2018-2019) ku janë përfshirë në program 7 (shtatë) pedagogë efektivë prej të cilëve 2(dy) janë me Titull Profesor i Asc dhe 2(dy) me gradën Doktorë Shkencash.

Nuk ka ndryshime në planin mësimor krahasuar me planin mësimor të licensuar. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion programi mësimor është i organizuar në tre vite akademike me 60 ETC secili, në total 180 ETC.

*Mjekësia transfuzive është një disiplinë themelore e mjekësië së sotme moderne si në fushën e diagnostikës ashtu dhe trajtimin jomedikamentos të një sërë sëmundjeve. Në tregun e punës ka kërkesë për specialist laborator në këtë fushë si në strukturat spitalore publike dhe jo publike, në bankat e gjakut dhe laboratorët mjekësorë jo publikë për realizimin e shërbime laboratorike ndaj pacientëve të lidhura me këtë specialitet. Për sa më sipër rekomandojmë përfshirjen në programet e studimit të njohurive bazë në Mjeksinë transfuzive.*

#### **GVJ në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit sugjeron këto ndryshime:**

1. Shtimin e Lëndës Mjekësi transfuzive, ose futjen e leksioneve të dedikuara në lëndën e imunologjisë.
2. Heqjen e lëndës Kimi Analitike duke riorganizuar programin e Kimisë inorganike
3. Zhvendosjen e Lëndës Biokimi e Aplikuar Klinike në vitin e dytë, pasi studenti të ketë marrë njohuritë e nevojshme në Biologji dhe Biokimi.
4. Të rriten kreditet e lëndës Biokimi Klinike, ku mund të përfshihen edhe njohuri të cilat sot jepen ne lende te vecanta si Onkologjia, Vlerësimi i Sëmundjeve Reumatizmale apo Obsetrika, mendojme se numri i kredive në këto lëndë është i lartë. GVJ arsyeton se lëndët me karakter klinik zënë një numër të madh kreditesh në program duke mos i shërbyer misionit dhe objektivave të formimit të Teknikëve të Laboratorëve Mjekorë, GJV sugjeron që të rishikohët shpërndarja e krediteve ne favor të lëndëve Teknike Laboratorike apo lëndëve që i shërbejnë vlerësimit dhe diagnozës laboratorike.
5. Të shikohet mundësia e shtimit të temave të Biofizikes dhe Optikës ndoshta në një lëndë të veçantë.
6. Rritja e kredive në Teknika të Anatomisë Patologjike.
7. Të futet si lëndë e veçantë ose cikël leksionesh Automatizimi në Laboratorët Mjekesorë dhe Sistemet e Informatizimit Laboratorik (LIS).

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës  
(Tabelën, në Aneksi)

Personeli akademik që mbulon aktualisht programin Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përbëhet përgjithësisht nga staf specialist me kualifikim të lartë, pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakterizuese të kategorise B, janë Mjekë Specialiste të Mjekësisë Laboratorike në fushat e Biokimise Klinike, Hematologji, Mikrobiologji dhe Anatomisë Patologjike dhe me kompetencë të lartë në këto fusha. *Në dy raste fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me sylabusin e lëndës në të cilën është lektor duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies.*

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit

Janë deklaruar të dhënat lidhur me emërtimet e cdo lënde dhe moduli.

- Viti/semestri kur zhvillohet lënda

Eshtë deklaruar qartë viti/semestri ku zhvillohet lënda

- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën

Eshtë deklaruar emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, pas vizitës në institucion syllabuset janë riorganizuar duke diferencuar lektorin nga titullarin e lëndës.

- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit

Eshtë deklaruar qartë në syllabus vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit.

- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës

Për secilën lëndë janë dhënë qartë kushtet për njohuritë paraprake.

- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë

Cdo program lënde është shoqëruar me një përmbledhje të aftësive, njohurive dhe kompetencave që lënda i jep studentit.

- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik

Tematikat janë përshkruar në mënyrë të detajuar sipas formave të mësimdhënies dhe orëve përkatëse për secilën temë. *Jo në të gjithë syllabuset nuk është zbatuar formati sipas vendimit nr41, dt 24.1.2018 i MASH ku përfshihet dhe numri faqeve në literaturë.*

- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS

Në planin mësimor është dhënë numri i orëve në auditor dhe jashtë auditorit për secilën lëndë të programit studimor.

- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre

Janë deklaruar format dhe metodat e mësimdhënies dhe raportet mes tyre.

- Format e vlerësimit të studentëve

Eshtë paraqitur mënyra e vlerësimit të studentëve shoqëruar dhe me sqarimet përkatëse.

- Detyrimet e studentit për lëndën

Në rregullore, në planin mësimor dhe në syllabuse janë përcaktuar detyrimet e studentit për lëndën.

- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Për cdo lëndë është deklaruar literatura.

*Theksojme që ka disa lëndë të cilat përdorin të njëjtën literature, në disa lënde literatura bazë është në gjuhë të huaj.*

- Analizë e cilësisë së syllabuseve:



Tematikat e syllabuseve janë në përgjithësi bashkëkohore dhe në koherencë me programin e studimit. Syllabuset janë aprovuar nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Në asnjë prej syllabuseve nuk përcaktohet titullari i programit. Në asnjërin prej syllabuseve nuk është vendosur numri i faqeve të literaturës për çdo temë duke mos zbatuar vendimit nr.41, dt 24.1.2018 të MASH. Literatura i një pjese të syllabuseve duhet përmirësuar. Sugjerojmë që në dispozicion të studentëve, kryesisht në lëndët karakterizuese, të vendoset literaturë e shkruar në formë të broshurave nga lektorët dhe të depozituara në departament dhe bibliotekë.

- Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

Në institucion u konsultuan dhe një herë syllabuset e lëndëve, programet mësimore. GVJ në funksion të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë ka sygjëruar ndryshime në planin mësimor.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS):</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Program i studimit “Teknikë Laboratori Mjekësor” është hapur më 22.04.2016 me urdhër Nr.187 të MASR “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë, “Bachelor” në “Teknikë Laboratori Mjekësor”.</p> <p>Ky program është formuluar në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi mbi organizimin e programeve për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe organizohet në lëndë/module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një vit akademik përmban 60 kredite, ne total 180 ETC për tre vitet e programit.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin</p>	<p>Departamenti përgjegjës i programit Teknikë Laboratori Mjekësor vë në dispozicion informacion e nevojshëm për</p>

informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

**Kriteri 3** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

**Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

programin e studimit ndërmjet faqes [eee.ual.edu.al](http://eee.ual.edu.al):

Departamenti jep informacionin e nevojshëm për lëndët e detyruara, lëndët me zgjedhje, ngarkesën mësimore, frekuentimin, praktikat dhe orët laboratorike.

Para fillimit të lëndës/modulit cdo pedagog ju paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitet e përfshira në të për zhvillimin e mësimin. Informacioni i verifikua gjatë komunikimit me stafin dhe studentët.

#### **Konkluzionet e GVJ:**

1. Programi i studimit është në përputhje me misionin dhe objektivat specifike si dhe përshtatet me nevojat e tregut të punës. Programi është strukturuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi si dhe direktivat e BE për arsimin e lartë. Ai realizohet në kohëzgjatje normale prej një viti dhe 180 ECTS.
2. Në planin mësimor shpërndarja e krediteve për forma të ndryshme të mësimdhënies, është zbatuar në mënyrë të saktë.
3. Personeli akademik që mbulon aktualisht programin Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë përbëhet nga personalitete me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse, kryesish Mjekë Specialistë të Mjekësisë Laboratorike. *Vetëm në dy raste fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është lektor duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies.*
4. *GVJ sugjeron në funksion të rritjes së cilësisë ndryshime në program, futje lëndësh të reja dhe riorganizim lëndësh dhe rishpërndarje kreditesh .*
5. Syllabuset janë në përputhje me misionin dhe objektivat e programit të studimit. *Grupi i vlerësimit evidenton disa probleme në formatimin e tyre, në ndonjë rast literaturë të papërshtatshme.*
6. *GVJ sugjeron futjen e literaturës në formë të broshurave të përpiluara nga lektorët në lëndët të cilat nuk kanë tekste të dedikuara në gjyhen shqipe, me qëllim rritjen e cilësisë.*

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në rregulloren e programit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë dhe në planin mësimor e syllabuset e lëndëve/moduleve janë përcaktuar qartë organizimi dhe mënyra e funksionimit të mësimdhënies. Jepen të detajuara format e mësimdhënies, ngarkesa në orë dhe ETCS, mënyrat e kontrollit të dijes etj.

Institucioni parashikon mënyrën dhe metodat e vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies nga NJBSC dhe koordinatori i programit. Teknologjia dhe paisja e laboratorëve me aparatura dhe mjete didaktike në mbështetje të mësimdhënies është e mjaftueshme, cilësore dhe brenda standarteve bashkëkohore. Shpërndarja e e orëve në bazë të formave të mësimdhënies është ndërtuar duke respektuar kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë.

IAL angazhohet në rritjet e cilësisë së mësimdhënies duke nxitur mësimin interaktiv, punën në grup, realizimin e prezantimeve. Në dispozicion të procesit akademik ishte vënë një hapësirë virtuale (google classroom) të cilën pedagogët publikojnë materiale didaktike të aksesueshme për studentët si përmbledhje të leksioneve në PPT, linke, foto dhe video mësimore, afatet dhe detyrimet e studentit për lëndën/modulin etj.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione 816
- Seminare 332
- Laboratore 612
- Praktikë profesionale 360
- Projekte 12

Programi studimor ka parashikuar format e mësimdhënies të mësimdhënies. Orët totale në auditor dhe raportet për secilën lëndë të formave të ndryshme të mësimdhënies janë evidentuar në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe në planin mësimor. Në planin mësimor llogariten 2178 orë totale në auditor. ***Këto të dhëna nuk përputhen me të dhënat e syllabuseve të veçanta, dhe me tabelat e RVB ku orët totale llogariten 2132.*** Plani mësimor i saktë është vendosur në sistem vetëm, pas hartimit dhe shqyrtimit të draft raportit nga instucioni. Sqarimet e GVJ janë dhënë në memo.

Format e kontrollit të njohurive

Në cdo lëndë pasqyrohen qartë format e kontrollit të njohurive. Për vlerësimin përdoret sistemi shqiptar me nota nga 4 në 10 si me poshtë:

Nota 4 0-40

Nota 5 41-50

Nota 6 51-60

Nota 7 61-70

Nota 8 71-80

Nota 9 81-90

Nota 10 91-100

Në syllabusin e lëndës përcaktohet edhe përqindja (pikëzimi) që zënë në vlerësimin total elementët e tjerë të kontrollit të dijes si pjesëmarrja, detyrat, labororet, testimet gjatë vitit etj.

*Vihet re që mënyra e vlerësimit nuk është e standartizuar, raportet e pikeve të marra nga provimi përfundimtar me pikët e marra nga forma të tjera vlerësimi ndryshojnë, në disa syllabyse ky raport është 80/20, në disa 70/30 dhe në një pjesë të vogël 60/40. GVB sqaron në memo, që mënyra e vlerësimit është*

*përcaktuar më vendim senati.* GVJ thekson se ky dokument është vendosur në sistem vetëm pas hartimit dhe shqyrtimit të draft raportit nga instucioni, ky koment është pasqyruar edhe në memo.

Studimet mbyllen me provimin përfundimtar të dipllomës, nuk parashikohet mbrojtja e temave në mbyllje të studimeve. GVJ rekomandon që në bazë të kriterëve të mirëpërcaktuara një pjesë e studentëve të mbyllin studimet me mbrojtje teme, kjo shkon në funksion të rritjes së cilësisë dhe motivimit të studentëve.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktivizimi i studentëve në projektet shkencore të institucionit dhe të pedagogëve është një nga detyrat e institucionit. UA ka organizuar konferencën studentore me qëllim promovimin e punimeve që studentët kanë bërë në bashkëpunim me pedagogët e tyre në rang departamenti po dhe jashtë tij.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve bazohen në kriteret e përcaktuara nga MASH dhe në rregulloren e programit të studimit dhe në nenet përkatëse të transferimit të studentëve.

Institucioni ka vendosur kriteret shtesë për pranimin e studentëve, më vlerësim të notës mesatare në grup lëndësh. Nota mesatare hyrëse e studentëve për vitin akademik 2018-2019 është **7.93**. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program është i lartë, 65 studentë në vitin aktual akademik. Numri i lartë i regjistrimeve dhe nota e lartë mesatare në hyrje tregon interesin e studentëve për këtë program.

Institucion realizon transferime të studentëve nga programe të tjera të njëjta ose të ngjashme në bazë të një procedurë të përcaktuar. Procedura dhe kriteret e transferimeve na u vu në dispozicion gjatë vizitës në Institucion.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi i studentëve në programin Bachelor në "Teknikë laboratorit mjekësor" është kryer në mbështetje të ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" mbi Vendimet e Këshillit të Ministrave që lidhen me përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë, gjithashtu instucioni ka vendosur kriteret specifike pranimi për çdo vit akademik, në RVB dhe gjaë takimeve na u tha se kriteret e pranimit janë vendosur me vendim senati.

### Më poshtë kriteret specifike të pranimit për vitin akademik 2018-2019:

60% mesatare e shkollës së mesme 40% gruplëndët preferenciale ( Kimi 10%, Biologji 10%, Gjuhë e huaj e parë 10%, TIK 5%, Qytetari 5%).

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Vlerësimi i cilësisë së studentëve në hyrje dhe dalje të programit të studimit realizohet duke marrë në konsideratë dhe duke krahasuar rezultatet e arsimit të mesëm me rezultatet e studentit të diplomuar. Instucioni ende nuk ka diplomuar studentet e parë dhe GVJ nuk mund të bëjë një vlerësim, *vihet re një mesarate e kenaqëshme e arsimit të mesëm në hyrje të studenteve.*

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

- 57 studentë në vitin akademik 2016 – 2017 /Nota mesatare 8.07
- 39 studentë në vitin akademik 2017 – 2018 /Nota mesatare 7.72
- 65 studentë në vitin akademik 2018 – 2019 /Nota mesatare 7.93

Viti akademik me numrin e regjistrimeve më të larta është viti aktual akademik 2018-2019, dhe me numrin më të ulët vitin 2017-2018. Nota mesatare për të tre vitet në hyrje është varion nga 7.72-8.07.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Programi nuk ka ende studentë të diplomuar.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Institucioni parashikon mobilitet të studentëve drejt institucioneve të tjera ose nga institucionet e tjera në vend. Institucion ofron njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi ose programeve të ngjashme. Transferimi njihet vetem brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha të njëjta ose të përafërta. Departamenti përgjegjës në bazë të udhëzimeve të MASH nge komisionin Ad Hoc për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve. Gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion dhe na u sqarua praktika e transferimeve.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Ligji ka ndryshur si duhet shkruar	Pranimi i studentëve në programin Bachelor në "Teknikë laborator mjekësor" kryer në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe mbi vendime e përvitshme të Këshillit të Ministrave që lidhet me përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë si dhe kriterëve specifike të përcaktuar në vendimet e Senatit akademiktë Universitetit "ALDENT".
<b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të	



studimeve.	
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët janë informuar në mënyrë të detajuar për përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor, afatin e përfundimit, mënyrën e organizimit stadin e procesit të akreditimit, kjo na u tha gjatë takimit që patëm me studentët e këtij programi studimi nëpërmjet faqes zyrtare <a href="http://www.ual.edu.al">www.ual.edu.al</a> katalogëve të Universitetit si dhe nëpërmjet platformës elektronike <b>FxEducation</b>.</p> <p>Studentët bëjnë vlerësimin procesit mësimor me anë të <i>pyetësorëve të hartuara nga NJSBC, GVJ ve re që në pyetësor nuk ka pyetje për secilin pedagog, me qëllim ruajtjen e privatësisë sipas deklaratës së anatarëve të NJSBC</i></p> <p>Institucioni ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës që iu jep informacion studentëve për mundësitë e punësimit. Kjo zyrë organizonte edhe takime me studentët, ku ata njiheshin me konferencat apo aktivitetet të ndryshme që organizohen nga IAL.</p>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni ende nuk ka diplomuar studentët e parë në këtë program studimi. Institucioni disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar transferuar në programin e studimit Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor. Institucioni disponon një bazë të plotë të dhënash për ecurinë akademike të studentëve që nga momenti i regjistrimit.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Në funksion të këshillimit të studentëve, asistencës për problematika që lidhen me procesin mësimor, në UAL funksionon jo vetëm Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Qendra e Kërkimit Shkencor. Në këtë proces janë të përfshirë aktivisht dhe anëtarët e stafit akademik. Praktikrat profesionale jashtë institucionit nuk janë të parashikuara në këtë program studimi, megjithatë në rastet kur kërkohet nga studentët, Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) i orienton dhe rekomandon në qendrat mjekësore ku kërkojnë të kryejnë praktikë profesionale.</p>
<b>Konkluzionet e GVJ</b>	
<p>1. Informacioni në lidhje me studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është i evidentuar qartë në statutin dhe rregulloren e KU Logos si dhe në</p>	

rregulloren e programit të studimit Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor.

2. Studentët janë vazhdimisht nën kujdesin e stafit akademik dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës lidhur me komponentët e procesit mësimor dhe të punësimit të ardhshëm.
3. Në institucion funksionon Këshilli studentor që japin ndihmesën e tyre në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në zgjerimin e informacionit për tregun e punës dhe mundësitë e mobilitetit.
4. Institucioni përgatit raporte vjetore për arritjet dhe problematikat e procesit mësimor, të paisur me tabela dhe grafikë për vitin dhe krahasuese mes viteve.
5. Institucioni ka vendosur kritere shtesë për pranimin e studentëve dhe ka procedurë të percaktuara transferimi të studimeve.

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor është një komponent i rëndësishëm në aktivitetin e UAL. Institucioni inkurajon dhe orienton stafin si dhe studentët drejt kërkimit shkencor, botimeve, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore etj. UAL mbështet stafin akademik dhe studentët financiarisht për pjesëmarrjen në konferenca apo ëorkshope trainimi brenda dhe jashtë vendit, për botime të artikujve në revista shkencore, si dhe botimin e një reviste online nga vetë UAL. Në mbështetje të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor janë investimet e bëra në ngritjen e laboratorëve të rinj në departamentin e laboratorëve dhe imazherisë. Studentët e vitit të tretë të këtij programi në drejtimin e pedagogëve të tyre janë përfshirë në kryerjen e tema studimi me karakter shkencorë.

UAL organizon çdo vit Konferencën shkencorë studentore, ku studentët prezantojnë punimet tyre të udhëhequr nga pedagogët.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ të dhënat lidhur me kërkimin shkencor, tabelat përkatëse lidhur me numrin e botimeve, pjesëmarrjen në konferenca brënda dhe jashtë vendit të stafit akademik, etj (referuar raportit të GBV).

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Personeli akademik i UAL gjatë vitit akademik 2017-2018, ka patur 12 artikuj të botuar në revista shkencore brënda dhe jashtë vendit si dhe dy mnografi (Referuar raportit të GVB).

- Numri i projekteve kërkimore të fituara

Nuk ka në këtë program studimi

- Numri i projekteve të zbatuara

Nuk ka të dhëna në këtë program

- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

2 konferenca shkencore studentore të organizuara gjatë dy viteve të fundit.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL

Nuk ka të dhëna

- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Gjatë vitit akademik 2018-2019 në departamentin e laboratorëve mjekësorë janë në proces 4 tema projekte shkencore ku përfshihen studentët e vitit të tretë të udhëhequr nga pedagogët efektivë të këtij program studimi të mbështetura financiarisht nga UAL.

- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Në projekte shkencore janë përfshirë rreth 25 studentë të vitit të tretë teknikë laborator.

- Numri i Çmimeve Kombëtare

Nuk ka të dhëna

- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

Të dhënat janë marrë gjatë intervistët me stafin dhe koordinatorin e kërkimit shkencorë të institucionit si dhe RVB ku janë vënë në dispozicion: tabelat përkatëse me numrin e botimeve për çdo pedagog, librat e botuara nga stafi, materialet e konferencave të organizuara, dokumenta në lidhje me strategjinë e financimit të kërkimit shkencor në të ardhmën etj.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

UAL në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ka nënshkruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si Universitetin Mjekësor në Tiranë, kolegji HEIMER, Universitetin Istinyie, Stamboll Turqi, Universitetin Acibadem, Stamboll, Turqi, Universitetin Ankarasë, Universiteti D'Annunzio i Chieti, Itali. Marrëveshjet parashkruajnë mobilitet të personelit akademik dhe të studentëve për module të veçanta, organizim të aktiviteteve të përbashketa, pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore. Marrëveshjet me institucionet arsimore të Polonisë, Lituanisë

dhe Italisë janë në kuadër të programeve Erasmus + dhe përfshijnë shkëmbimin e stafit dhe të studentëve. UAL ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe jo publike si ASHR, Laoratori Genius, laboratroi Intermedika ku studentët realizojnë praktikën profesionale apo projekte të përbashkëta kërkimi. Deri me tani nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione Qeveritare dhe me Organizata profesionale.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**


- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
  - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare.  
Nuk ka të dhëna
  - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj  
Nuk ka të dhëna
  - Numri i pjesëmarrësve në trainime ne fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit  
Nuk ka të dhëna
  - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL  
Ska patur
  - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor

Në funksion të kërkimit shkencorë egziston infrastruktura e nevojshme si laboratorike ashtu dhe literatura e nevojshme në gjuhën shqipe dhe të huaj.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 12 artikuj të botuar në revista shkencore ku stafi efektiv ka qenë autor ose bashkautor si dhe 2 monografi shkencore

Stafi i UAL ka marrë pjesë në 10 aktivitete shkencore brënda dhe jashtë vendit me 59 referime të pjesëmarrësve në aktivitete shkencore kombëtare dhe 4 në aktivitete shkencore ndërkombëtare, 10 pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare apo drejtues shkencor si dhe anëtar i bordit drejtues.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
  - Institucionet qeveritare bashkëpunuese  
Nuk ka
  - Organizatat Profesionale  
Nuk ka
  - Komuniteti i biznesit, tregu i punës
    - Laoratori Genius SHPK
    - Laboratori Intermedika
    - ASHR



Dokumentacioni përkatës

Gjatë vizitës në institucion GVJ ju vunë ë dispozicion marrveshjet e bashkëpunimit të nënshkrura me institucione të arsimit të lartë në funksion të mësimdhënies, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencorë të UAL me universitetin Acibadem në Turqi, Universitetin e Ankarasë dhe Universitetin Istynie.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Institucioni inkurajon bashkëpunimin ndërmjet personelit për probleme të hartimit të programit e planit mësimor, realizimit të tij dhe kërkimit shkencor kryesisht përmes qendrës së Kërkimit Shkencor.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Organizimi i punës në institucion bëhet në frymën e bashkëpunimit duke respektuar hierarkinë dhe statutin. Kjo frymë bashkëpunimi dhe gjithpjesmarrjeje u evidentua dhe gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm në institucion. Institucioni realizon Analizën vjetore të punës, e cila u verifikua nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në vend.
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	Për realizimin e objektivave të programit bachelor Teknik Laboratori Mjekësorë, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit vendas si më poshtë: Kontrata bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe jo publike si ASHR, Laboratori Genius, laboraroi Intermedika ku studentët realizojnë praktikën profesionale apo projekte të përbashkëta kërkimi.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;	– Bashkëpunimi me institucione kombëtare të arsimit të lartë si UMT, kolegji HEIMER, Universitetin Istynie, Stamboll Turqi, Universitetin Acibadem, Stamboll, Turqi, Universitetin Ankarasë, Universiteti D'Annunzio i Chieti, Itali etj, në fushën e kërkimit shkencorë, organizimin e aktiviteve shkencore apo shkëmbime të stafit akademik dhe studentëve për module të veçanta.
<b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	– Organizimin e aktiviteve shkencore nga Universiteti Aldent si Konferenca shkencor vjetore e studentëve.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	– Marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore të huaja në fushëm e kërkimit shkencorë, zhvillimin e programeve studimore si vizita studimore të studenteve, shkëmbim të të dhënave kërkimore akademike dhe materiale teknike, shkëmbime të stafit akademikë organizime të konferencave/seminareve të përbashkëta
	Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet shëndetësore publike dhe jo publike për kryerjen e praktikës profesionale por nuk ka një praktikë dhe rregullore të qartë për vlerësimin e praktikës profesionale të studentit nga


	<p>punëdhënësi dhe vlerësimi nga pedagogu mbikqyrës. Sugjerojmë që të përpilohen formate konkrete vlerësimi të praktikës nga punëdhënësi dhe pedagogu mbikqyrës.</p> <p>Aktualisht institucioni organizon trajnime profesionale lidhur me programet e studimit që ofron UAL.</p> <p>Institucioni ruan bazën e të dhënave të vlerësimit të studentit në praktikën profesionale.</p>
<p><b>Konkluzionet e GVJ</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni inkurajon bashkëpunimin ndërmjet personelit për probleme të hartimit të programit e planit mësimor, realizimit të tij dhe kërkimit shkencor kryesisht përmes qendrës së Kërkimit Shkencor</li> <li>2. UAL ka marrëdhënie bashkëpunimi të konsoliduar me institucione shëndetësore publike dhe jo publike të fushës laboratorike për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve me teknologji të avancuar bashkëkohore. Po ashtu ky institucion ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda e jashtë vendit përmes të cilave inkurajon dhe promovon specializimin e pedagogëve të rinj dhe shkëmbimet e studentëve</li> <li>3. Janë realizuar këmbime të stafit apo të studentëve në rang institucioni me institucione të tjera universitare homologe, <i>por në asnjë rast studentet dhe stafi nuk i përkës këtij program studimi.</i></li> <li>4. Vlerësojmë që infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor në institucion është e mjaftueshme dhe bashkëkohore.</li> </ol>	

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me “Analizën përmbledhëse të RVJ” sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### a. Pika të forta:

- 1) Programi i Studimit programit Bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor”. organizohet dhe realizohet në një institucion me eksperiencë 12 vjecare dhe me profilizim Mjekësor.
- 2) Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit paraqitet e përshtatshme dhe e mjaftueshme për realizimin e tij. Labororet mesimore janë të dedikuara dhe të plotësuar me mjete didaktike, duke garantuar realizimin me sukses të praktikave laboratorike.
- 3) Staf i në përgjithësi ka kualifikim dhe eksperiencë profesionale për realizimin e programit
- 4) Moshë e personelit akademik efektiv, e cila në këtë program studimi është relativisht e re, krijon institucionit një të ardhme më të sigurtë.
- 5) Institucioni ka një politikë mbështetëse dhe inkurajuese për studentin. Ai i siguron studentit jo vetëm përgatitje teorike dhe praktikë profesionale në institucione laboratorike në funksion të përgatitjes për tregun aktual dhe perspektiv të punës.
- 6) Ekzistenca e platformës elektronike FxEducation e cila koordinon të dhënat e sekretarisë mesimore, stafit akademik dhe studentëve.
- 7) Rritja e qëndrueshme financiare e institucionit gjatë viteve të fundit, duke krijuar mundësi për investime të mëtejshme në funksion të përmirësimit kushteve të mësimdhënies.



**b. Pika të dobëta:**

- 1) Mospërputhja në dy raste e fushës së ekspertizës së pedagogut me lëndën që mbulon në këtë program studimi si pasojë e mungesës së personelit akademik efektiv të profilit Mjekë të Specializuar në fushën e Mikrobiologjisë.
- 2) Numër i lartë lëndësh të cilët mbulohen nga një pedagog i evidentua në dy raste.
- 3) Numri i lartë i ECTS në disipinat me profil klinik krahasuar me lëndet teknike laboratorike dhe lëndët në funksion të diagnostikës së mjekesisë laboratorike.
- 4) Angazhimi i ulët i stafit i cili mbulon këtë program studimi në projekte konkrete kërkimore shkencore, botime etj.
- 5) Mungesa e konkretizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Instucionet e tjera ndërkombëtare të arsimit të lartë në fushën e Mjekësisë Laboratorike.

**c. Mundësitë:**

- 1) Vënia në eficiencë të plotë e laboratorëve, standartizimi, modernizimi dhe akreditimi i tyre mundëson pozicionimin e dukur të IAL. Aldent në fushën e diagnozës laboratorike dhe të kërkimit shkencor.
- 2) Ky program studimi është një programet më të kërkuara në funksion të rritjes së shërbimit shëndetsor në vend.
- 3) Mundësitë për mobilitet të studentëve dhe stafeve akademike përmes projekteve dhe programeve të BE.
- 4) Ndërtimi i Kampusit të ri universitar do të krijojë më shumë ambiente dhe facilitate në funksion të jetës akademike.
- 5) Rritja në numër dhe venia në funksionim e bashkëpunimeve ndërkombëtare në funksion të zhvillimit shkencor dhe mobilitetit të stafit dhe studenteve.

**d. Pengesat:**

- 1) Mungesa e një tregu te konsoliduar e të rregulluar të arsimit të lartë jopublik.
- 2) Pengesa relative për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesëshme, me titull profesor ose profesor i asociuar; dhe e stafit akademik të specializuar në Mjekësinë Laboratorike.

**e. Rekomandime**

- 1) Rekrutimi i stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesëshme të Mjkeve të Specializuar në fushën Mikrobiologjisë Mjekësore me qëllim mbulimin e të gjithë lëndëve me ekspertë të fushës.
- 2) Pasurimin e mëtejshëm të laboratorëve më paisje laboratorike të një teknologjir sa më të avancuar.
- 3) Përmirësimi i syllabuseve në formë dhe përmbaje.
- 4) Rekomandojmë që në të ardhmen në kuadër të përmirësimit të planit mësimorë institucioni të shohë mundësinë e disa ndryshimevet si më poshtë:

- a. Shtimin e Lëndës Mjekësi Transfuzive, ose futjen e leksioneve të dedikuara në lëndë të tjera.
  - b. Riorganizimi i programin të Kimisë inorganike dhe Analitike.
  - c. Të rriten kreditet e lëndës Biokimi Klinike, ku mund të përfshihen edhe njohuri të cilat sot jepen në lëndë të vecanta si Onkologjia, Vlerësimi i Sëmundjeve Reumatizmale apo Obsetrika.
  - d. Të shikohet mundësia e shtimit të temave të Biofizikes dhe Optikës ndoshta në një lëndë të veçantë.
  - e. Rritja e kredive në Teknika të Anatomisë Patologjike.
  - f. Të futet si lëndë e veçantë ose cikël leksionesh në lëndë të tjera Automatimi në Laboratorët Mjekësorë dhe Sistemet e Informatizimit Laboratorik (LIS).
- 5) Përpilimin e formateve apo mini broshurave të vlerësimit të studentëve gjatë praktikave profesionale jashtë institucionit.
  - 6) Rekomandojmë që një pjesë e studentëve të mbyllin studimet më mbrojtje diplome, në bazë të kritereve të përcaktuara nga institucioni.
  - 7) Të shtohen marrëveshjet e bashkëpunimit me laboratore që ofrojnë teknologji bashkëkohore me qëllim krijimin e mundësisë së zhvillimit efektiv të praktikave për të gjithë studentët , të cilët janë në numër të konsiderueshëm në këtë program studimi.
  - 8) Nxitjen dhe aktivizimin e programit ERASMUS + me qëllim rritje e mobilitetit drejt intitucioneve të tjera të arsimit të lartë.
  - 9) Rafinimi i materialeve të studimit në gjuhën shqipe, kryesisht për lëndët kryesore të programit.

#### **COMPREHENSIVE SUMMARY OF THE STUDY PROGRAMMES' IMPLEMENTATION PROCESS**

EER concludes with the "Comprehensive Summary of EER", in accordance with the **SWOT (Strengths, Weaknesses ,Opportunities, Threats)** analysis method.

##### **a. Strengths:**

- 1) Study Program Bachelor in "Medical Laboratory Technique". is organized and implemented in an institution with 12 years of experience and with medical profiling.
- 2) The available infrastructure of the study program is adequate and sufficient for its realization. Learning laboratories are dedicated and met the teaching tools, ensuring the successful realization of laboratory practices.
- 3) Staff generally has the qualifications and professional experience to carry out the program.
- 4) The age of the effective academic staff, which is relatively young in this study program, creates a more secure future for the institution.
- 5) The institution has a supportive and encouraging policy for the student. It provides the student with not only theoretical preparation but also professional practice in other Laboratory Institutions with a view to preparing students for the current and prospective labour market.



- 6) The existence of electronic platform FxEducation which coordinates the data of teaching secretariat, academic staff and students.
- 7) Sustainable financial growth of the institution during the last years, creating opportunities for further investments in order to improve the conditions of teaching.

**b. Weaknesses:**

- 1) Inconsistency in two cases of the pedagogue's area of expertise with the subject covered in this study program due to the lack of effective academic staff in the field of Microbiology.
- 2) High number of subjects covered by a lecturer identified in two cases.
- 3) High number of ECTS in the disciplines with clinical profile compared to laboratory technical subjects and subjects dedicated laboratory medicine diagnostics.
- 4) Low engagement of staff who cover this study program in specific scientific research projects, publications etc.
- 5) Lack of concretization of cooperative agreements with other international institutions of higher education in the field of Laboratory Medicine.

**c. Opportunities:**


- 1) Full operationalization of laboratories, their standardization, modernization and accreditation enable the prominent positioning of HEI Alden in the field of medical laboratory diagnosis and scientific research.
- 2) This study program is one of the most favorite in function of enhance health care in the country.
- 3) Opportunities for mobility of students and academic staff through EU projects and programs. The construction of the new University Campus will create more facilities for the purpose of academic life.
- 4) Increasing the number and launching of international collaborations in view of the scientific development and mobility of staff and students.

**d. Threats:**

- 1) Lack of a consolidated and regulated non-public higher education market.
- 2) The relative burden in recruiting full-time academic personnel, especially with the qualifications of Professor or Associate Professor, as well as Laboratory Medicine personnel.

**e. Recommendations**

- 1) Recruitment of full-time or part-time Medical Staff Specialists in the field of Medical Microbiology in order to cover all subjects with field experts.
- 2) Further enrich the laboratories with the most up-to-date laboratory equipment of the latest technology.
- 3) Improve syllabuses in form and content.
- 4) We recommend that in the future in the context of improving the syllabus the institution



sees the possibility of some changes as follows:

- a. Adding Transfusion Medicine, or introducing dedicated lectures in other subjects.
  - b. Reorganization of the program of Inorganic and Analytical Chemistry.
  - c. Increase the credits of the Clinical Biochemistry course, which may include knowledge that is nowadays given in specific subjects such as Oncology, Rheumatic Disease or Obstetrics.
  - d. To consider the possibility of adding Biophysics and Optics topics perhaps in a particular subject.
  - e. Increasing credits in Pathological Anatomy Techniques.
  - f. Introducing as a separate course or lecture cycle in other courses Automation in Medical Laboratories and Laboratory Informatics Systems (LIS).
- 5) Compilation of student assessment formats or mini-booklets during professional practice outside the institution.
  - 6) We recommend that a part of the students to complete their studies with thesis, based on the criteria set by the institution.
  - 7) Increase cooperation agreements with laboratories that provide state-of-the-art technology to enable the development of effective internships for all students who are in significant numbers in this study program.
  - 8) Promoting and activating the ERASMUS + program with the aim of increasing mobility towards other higher education institutions.
  - 9) Refining the study materials in the Albanian language, primarily for the core subjects of the programme.

